**R E P U B L I K A  E S H Q I P Ë R I S Ë**

**BASHKIA ELBASAN**

**KESHILLI BASHKIAK**

**Njoftim për konsultim publik**

**Titulli i Projekt-aktit**: *"Plani Lokal i Menaxhimit te Integruar te Mbetjeve te Ngurta Urbane 2025-2030", Bashkia Elbasan*

**Propozuesi**: Gledian LLATJA*, Kryetari i Bashkisë, Lutfi LALA, Kryetar i Keshillit Bashkiak*

**Sqarime për projekt-aktin**:

**Kalendari i konsultimit** : Konsultimi publik do të realizohet sipas kalendarit të konsultimeve.

**Pjesëmarrës :**

- **Nga ana e Bashkisë:** Lutfi Lala, Kryetar i Keshillit Bashkiak Elbasan (KB), Anetaret e Komisionit te Sherbimeve, Strehimit Social, Shendetesise dhe Barazise Gjinore, Anetaret e Komisionit te Mjedisit KB, Anetaret e KB, Taulant Sinanaj, Drejtor e Monitorimit, Stafi i Sektorit te Analizave dhe Monitorimit te Sherbimeve Publike, Bashkia Elbasan, Stafi i Drejtorise se Tatimeve, Bashkia Elbasan.

- **Nga komuniteti:** Perfaqesues dhe anetare te komunitetit te Bashkise Elbasan, përfaqësues nga bizneset, përfaqësues nga shoqëria civile, përfaqësues te grupeve vulnerabël Romë, Egjiptianë dhe persona me aftesi te kufizuar.

**Format e konsultimit:** Tryeza diskutimi/Takime publike

| | |
|---|---|
| Qëllimi i konsultimit publik | *Këshilli i Bashkisë në zbatim të ligjit 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" i ndryshuar si dhe në zbatim të rregullores së Këshillit ka për qëllim të garantojë pjesmarrjen e komunitetit në vendimarrje si dhe te orgnaizojë konsultime publike duke marrë parasysh mendimin e komunitetit përjgatë procesit të konsultimit duke i përfshirë ato në draftin e propozuar nga Kryetari i Bashkisë.*<br><br>*Plani Lokal i Menaxhimit te Integruart te Mbetjeve te Ngurta Urbane prek të gjithë banoret, bizneset, institucionet e ndryshme brenda dhe jashte territorit te bashkise Elbasan.*<br><br>*Duke njohur rëndësinë e Menaxhimit te Integruar te Mbetjeve te Ngurta Urbane. Këshilli Bashkiak, si përfaqësues i komunitetit, kërkon të marrë më shumë informacion për ndikimin dhe efektet që ky vendim mund të ketë në komunitetin e Bashkisë, nëse ky projekt-vendim i shërben përmirësimit të jetës së komunitetit, nëse ai i shërben interesit publik si* |

| | |
|---|---|
| | *dhe nëse ai duhet miratuar siç është paraqitur, apo duhet të miratohet i përmirësuar.* |
| Përshkrimi i cështjes që trajton projekt-akti | *Bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" dhe ligjin nr.10463 datë 22.09.2011 PLMIMNU eshte instrumenti kryesor i planifikimit për përcaktimin e vizionit dhe objektivat specifikë, të mundshëm nga ana ekonomike dhe mjedisorë, në lidhje me drejtimet që do të ndërmarrë bashkia në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Këto objektiva specifikë duhet të reflektojnë orietimet e politikës kombëtare drejt menaxhimit të integruar të mbetjeve, të aktualizuara në gjendjen ekzistuese të bashkisë. Mbi bazën e objektivave specifikë të dakordësuar në të gjitha nivelet vendimarrëse dhe me grupet e interesit, plani fillon dhe analizon skenarët e mundshëm të organizimit të shërbimit të shoqëruar me koston përkatëse dhe politikën fiskale që duhet të ndjekë bashkia në mbulimin e plotë të kostos. Ai për përfundon me një plan veprimi konkret të ndarë në afate kohore, brenda një 5 vjeçari, sipas përgjegjësive përkatëse të aktorëve të përfshirë në zbatimin e planit. Plani është një dokument planifikimi, i cili merr fuqi të plotë me miratimin nga Këshilli Bashiak.* |
| Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut | 1. *Si e gjykoni situatën e menaxhimit te mbetjeve ne bahkine Elbasan?*<br>2. *A mendoni se plani dhe objektivat e tij i permbushin pritshmeritë tuaja në lidhje me përmirësimin e sherbimit?*<br>3. *Ç'farë sugjerimesh do të kishit ju, sugjerime të cilat nuk janë përfshirë në dokumentat e këtij projekt-akti, në mënyrë që situata ne menaxhimin e mbetjeve të ndryshojë vit pas viti në të mirë të te gjithe komunitetit?* |
| Detaje të çdo takimi publik apo dëgjese publike që do të organizohet në lidhje me projekt-aktin për këshillim | *Këshilli bashkiak nëpërmjet Komisionit të Sherbimeve do të bëje publik kalendarin e konsultimeve. Administrata e bashkise do të lehtesojë komunikimin me qytetarët dhe grupet e interesuara.*<br>*Do të vihet në dispozicion një adresë e-mail ku do të dërgohen rekomandimet e qyetarëve.* |
| Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve | *Kontaktet ku do të dërgohen rekomandimet janë:*<br>*Sekretariati i Keshillit Bashkiak:*<br>*Livia Guri, email: livia.guri@elbasani.gov.al*<br>*Alba Papa, email: albapapa04@gmail.com*<br>*albapapa87@gmail.com*<br>*Drejtoria e Monitorimi, Sektori i Analizave dhe Monitorimit te Sherbimeve Publike:* |

R E P U B L I K A  E SHQIPËRISË
**BASHKIA ELBASAN**
**KESHILLI BASHKIAK**

| | |
|---|---|
| | *Albert Hajrulla, e-mail: albert.hajrulla@elbasani.gov.al* |
| Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, studime apo materiale me informacion në lidhje me cështjen që konsultohet | *Draft Plani Lokal i Menaxhimit te Integruar te Mbbetjeve te Ngurta Urbane 2025-2030, Bashkia Elbasan, Projekt dhe Relacioni ndodhen te publikaur ne faqen e internetit të Bashkisë Elbasan, link: https://elbasani.gov.al/wp-content/uploads/2025/02/Draft-Plani-Lokal-i-Menaxhimit-te-integruar-te-mbetjeve-te-ngurta-urbane-2025-2030-Bashkia-Elbasan-1.pdf*<br><br>*https://elbasani.gov.al/wp-content/uploads/2025/02/Relacion-Plani-Lokal-i-Menaxhimit-te-Integruar-te-Mbetjeve-te-Ngurta-Urbane-2025-20230-Bashkia-Elbasan.pdf* |
| Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet qe do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit | *Këshilli siguron reagim ndaj komenteve, rekomandimeve, verejtjeve të dërguara nga publiku apo grupet e interesi për projektaktin/ projekt-politikën e shpallur për këshillim publik, përgjatë gjithë fazave të proçesit të këshillimit publik.*<br><br>*Në varësi të numrit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve, Këshilli, nepëmjet Sekretariatit, i dërgon konfirmimin e marrjes së tyre të gjithë dërguesve: me poste elektronike (individualisht), ose me poste te rregullt, përgjigje kolektive (me poste elektronike apo në portalin e këshillimit të Këshillit; nëse postohen në portal komente apo rekomandime nga palët që kanë kontribuar, brenda 15 ditëve pune nga postimi i përgjigjes kolektive, kjo do të konsiderohet si konfirmimi i marrjes së reagimit të Këshillit nga kontribuesi).* |
| Data e publikimit | *19.02.2024 Elbasan*<br>*Sekretariati i Këshillit Bashkiak* |